

TË PARAQISNI DHUNËN FAMILJARE NË POLICI

Policia është kompetente të sigurojë jetën dhe integritetin personal të viktimës së dhunës dhe të anëtarëve të tjerë të familje, zbulimin e kryerësve, pengimin dhe shkatërrimin e dhunës dhe parandalimin e saj, Pas paraqitjes së dhunës familjare, policia ka për detyrë të veprojë me reagim urgjent, në kohë dhe efikas për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe të sigurojë njëkohësisht dëshmi me qëllim që të zbatohet me sukses mbrojtja gjyqësore në procedurë qytetare, kundërvajtëse dhe penale.

KUSH MUND TË PARAQESË DHUNË FAMILJARE

Përveç viktimës personalisht, dhunë familjare mund të paraqesë çdo anëtar i familje, fqinj, i afërm, mik, koleg/kolege madje edhe kalimtari i rastësishëm nëse ka njohuri për ushtrim të dhunës familjare.

Gjithashtu, obligim ligjor për paraqitjen e dhunës familjare në stacioni policor apo qendrën për punë sociale ka edhe personi përgjegjës ose udhëheqës i institucionit i cili ushtron veprimtari nga fusha e: sociale, arsimit, shëndetësisë, punëve të brendshme dhe punësimit në situata kur posedojnë njohuri se një person e caktuar është viktimë e dhunës familjare.

SI MUND TË PARAQITNI DHUNËN FAMILJARE

Paraqitja mund të jetë:

- ✓ personalisht/drejtëpërdrejt në hapësirat e stacionit më të afërm policor nga vetë viktimia ose cilido person tjetër i cili paraqet ushtrim të dhunës familjare;
- ✓ në telefon në numrin 192 ose drejtëpërdrejt në numrin e telefonit të stacionit kompetent policor;
- ✓ gjithashtu, policia konsiderohet se është informuar nëse paraqitja penale i dërgohet Linjës nacionale pa pagesë celulare SOS për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të dhunës familjare (nr. tel. 070/141-700; 075/141-700 ose në tel.: 02/15 700)

E RËNDËSISHME! – Pa marrë parasysh mënyrën e paraqitjes, nëpunësi policor është i detyruar në librin për ngjarje ditore ta evidentojë në mënyrë elektronike çdo ngjarje të paraqitur, përkatësisht thirrjen telefonike si dhe aktivitetet dhe masat e ndërmarra nga policia në bazë të paraqitjes.

ÇFARË ËSHTË E NEVOJSHME TË DINI QË TË PARAQITNI DHUNË FAMILJARE NË POLICI

Çdo formë e dhunës familjare siç është dhuna fizike, psikike dhe seksuale është e palejueshme dhe dënohet. Nëse si viktimë ballafaqoheni me ndonjë nga format e dhunës familjare keni të drejtë të mbrojtjes pa pagesë dhe mbrojtjes gjyqësore me obligim zyrtar dhe të parandalimit të përsëritjes së dhunës familjare në procedurë qytetare dhe penale.

!!! E RËNDËSISHME !!! Kur paraqitni dhunë familjare nuk keni obligim ta përkufizoni formën e dhunës së ushtruar sipas të cilës është lloji i veprës penale.

!!! KI KUJDES !

Si ushtrues i dhunës familjare konsiderohet dhunuesi i cili është partner/partnere martesor/jashtëmartesor, i dashur/e dashur e tanishme apo e mëparshme apo anëtar i familjes me të cilin jetoni në të njëjtën amvisëri familjare!

Mënyra e paraqitjes së dhunës familjare, përkatësisht a të paraqisni personalisht apo në telefon varet nga mundësitë Tuaja si dhe nga shkalla e urgjencës dhe rrezikut të rrezikimit të sigurisë së jetës.

SI TË PARAQISNI RAST URGJENT TË RREZIKUT NGA DHUNA FAMILJARE

Nëse ballafaqoheni me rrezik nga dhuna familjare dhe ekziston rrezik serioz për sigurinë tuaj përpikuni:

- ✓ të mblidhni dokumentet e nevojshme, siç janë: letërnjoftimi, pasaporta, certifikatat e martesës, kartelat bankare dhe largojuni menjëherë nga mjedisi i dhunshëm dhe shkoni në stacionin më të afërm policor ose;
- ✓ paraqiteni dhunën në telefon në 192 dhe informojeni policinë me të dhënat dhe informacionet e domosdoshme për:
 - të dhënat tuaja personale, adresën dhe numrin e telefonit;
 - të dhënat e ushtruesit të dhunës familjare, incidente të mëparshme dhe dënime;
 - a ka armë, të lënduar, nevojë për shërbimet shëndetësore;
 - praninë e fëmijëve të mitur dhe të dhëna të tjera.

SI TË PARAQITNI DHUNË FAMILJARE PAS NGJARJES KRITIKE

Në situatë kur nuk bëhet fjalë për rast urgjent, përkatësisht, ngjarja ka ndodhur një ditë më parë, nevojitet sa më shpejt ta paraqisni dhunën në stacionin policor. Merrni me vete dokument për identifikim personal dhe nëse keni dokumentacion mjekësor për shërbimet shëndetësore të marra në lidhje me lëndimet e shkaktuara si pasojë e dhunës familjare.

Për shembull:

- ✓ raport nga cilido institucion shëndetësor ku është bërë kontroll mjekësor dhe janë konstatuar lëndimet trupore të shkaktuara nga dhunuesi;

- ✓ raport apo letër për dalje nga institucioni psikiatrik për gruan e cila ka duruar dhunë psikike nga bashkëshorti;
- ✓ raport nga gjinekologu për kontrollin e kryer te gruaja e cila ka duruar dhunë familjare.

VËREJTJE: Kërkesë, përkatësisht propozim për ndjekje penale kundër ushtruesit të dhunës familjare mund të iniciohet në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita kur ka ndodhur ngjarja e fundit kritike.

KUR PARAQISNI DHUNË FAMILJARE JEPNI ME PATJETËR:

- të dhëna në lidhje me kryesin / viktimën;
- kur, ku dhe çfarë ndodhi;
- a është lënduar dikush dhe kush është lënduar - përshkrimi me kronologjinë e ngjarjes;
- a ka armë / çfarë / ku;
- a ka pasur kërcënim, përpjekje për të përdorur armë;
- praninë e fëmijëve ose personave/dëshmitarëve të tjerë;
- a është larguar nga vendi i ngjarjes kryesi dhe në cilin drejtim është drejtuar;
- informacione nëse ekziston një masë e përkohshme e shqiptuar më parë për mbrojtjen nga dhuna në familje;
- a ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës;
- a ekziston ndonjë tjetër dhe kush është i rrezikuar;
- incidentet dhe paraqitjet e mëparshme të dhunës në familje (përshkruaj kronologjikisht që nga fillimi, shfaqja dhe përsëritja e dhunës në familje).

MËSIM: Nëse jeni të pasigurt ose keni mungesë të vetëbesimit, ju keni të drejtën ligjore për një shoqërues - person i rritur tek i cili keni besim për t'ju shoqëruar në stacionin policor. Ju ose shoqëruesi juaj mund t'i kërkonin oficerit të policisë të thërrasë një inspektor për dhunën në familje gjatë paraqitjes i cili e regjistron paraqitjen dhe i përcakton informacionin dhe të dhënat e nevojshme sipas të cilave bën vlerësim për ndërmarrjen e aktiviteteve të mëtejshme.

SI VEPRON POLICIA PAS PARAQITJES TË RASTIT TË DHUNËS FAMILJARE

Mënyra e veprimit dhe periudha në të cilën policia ndërmerr veprime pas paraqitjes me elemente të dhunës në familje nuk janë identike për secilin rast të raportuar. Secili rast është individual dhe veprimi varet nga fakti nëse rasti është regjistruar si ankesë apo si vepër penale për të cilën përpilohet një raport i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i paraqitjes ose gruaja që ka pësuar dhunë familjare.

E RËNDËSISHME! Policia është e detyruar me kërkesë të viktimës të lëshojë një certifikatë për secilin rast të raportuar të dhunës familjare, pavarësisht se a është regjistruar si ankesë apo vepër penale. Ruajini certifikatat e lëshuara nga policia për t'i bashkangjitur si provë në procedurat gjyqësore për: shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtjen nga dhuna familjare, divorcin, dhënien e kujdestarisë për fëmijët e mitur dhe pagimin e detyrimit ushqimor, dëbimin nga shtëpia familjare dhe për kontekstet e tjera familjare.

MËSIM! Paraqiteni dhunën edhe atëherë kur, përveç deklaratës suaj verbale, nuk keni dëshmitarë ose prova materiale se po ballafaqoheni me dhunë familjare. Për shembull, në rastin e dhunës psikologjike, është më e vështirë të identifikohen elementët e veprës penale, por megjithatë edhe pas paraqitjeve të tilla si ankesa, policia mund të vlerësojë ta thërrasë autorin e veprës dhe ta paralajmërojë atë me një dënim penal më të rreptë në rast të përsëritjes së veprës ose në konsultim me prokurorin publik të paraqesë menjëherë padi penale sipas detyrës zyrtare.

Gjatë rastit urgjent të dhunës familjare, obligim i policisë është të dalë menjëherë në vendngjarje.

Nëse dhuna zgjat ende, punonjësit policorë marrin masa për:

- sigurim të mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare dhe e ndalojnë dhunuesin në ushtrimin e mëtejshëm të dhunës;
- sigurim të ndihmës mjekësore për personat e lënduara (në një situatë të tillë informohet dhe thërritet shërbimi dezhurn i QPS dhe sipas nevojës viktimat dhe fëmijët e mitur strehohen në qendër të sigurt – qendër shellter);
- sigurim të materialit dëshmuar nga vendngjarja derisa sa të vijë ekipi mbikëqyrës.

Nëse nuk ka nevojë nga të dhënat e mësipërme, bëhet qasje për:

- bisedë të veçantë me viktimën dhe kryerësin e dhunës në vendngjarje;
- nëpunësi policor duhet ta mbajë bisedën profesionalisht, pa akuzime, stereotipa dhe paragjykime me fokus pyetje për ngjarje, kurse jo shkaqe për ngjarje;
- t'ju informojë me patjetër mbi zgjidhjet ekzistuese ligjore, shërbime për mbrojtje, ndërsa nëse është e nevojshme edhe strehim në vend të sigurt;
- t'ju informojë cilat masa dhe aktivitete do të ndërmerren kundër dhunuesit.

MËSIM: Lëndimet e shkaktuara si rezultat i dhunës në familje në formën e ënjtjeve, mavijosjeve, gërvishtjeve janë të kualifikuara në veprën penale Lëndimi fizik sipas n. 130 paragrafi 2 i KP-së për të cilën kërkohet me patjetër miratimi Juaj.

E RËNDËSISHME! Nuk mund të fillohet ndjekje penale për një vepër penale Lëndim trupor sipas n. 130 paragrafi 2 i KP-së nëse viktimat nuk jep miratim për ndjekje penale të kryerësit të dhunës familjare. Viktimat e dhunës familjare mund të tërheqë miratimin, pra të heqë dorë nga ndjekja penale në çdo moment deri në përfundimin e seancës kryesore para gjykatës penale të shkallës së parë.

NDËRMARRJA E VEPRIMEVE TË MËTEJSHME NGA POLICIA

Policia pas kontaktit me viktimën e dhunës familjare dhe pas të dhënave dhe informacioneve të përpunuara bashkëpunon me institucionet e tjera kompetente:

- e informon Qendrën për punë sociale – Njësinë për dhunë familjare për dhunën e kryer në familje me qëllim që të sigurojë mbrojtje adekuate dhe të fillojë mbrojtje gjyqësore prej ushtruesit në një procedurë qytetare urgjente për shqiptimin e masave të përkohshme të mbrojtjes në afat prej 8 ditësh;
- e paraqet me gojë ose me shkrim ngjarjen te Prokurori publik, këshillohet dhe në përputhje me udhëzimet dhe instruksionet e dhëna siguron prova shtesë për sqarimin e ngjarjes penale-juridike, konfiskon sende që mund të shërbejnë si prova për përcaktimin e mënyrës së kryerjes së veprës penale dhe për përcaktimin e përgjegjësisë penale ndaj kryerësit të raportuar të dhunës, përgatit një album me fotografi të lëndimeve të viktimës, kurse në varësi të peshës së veprës penale, nëse është e nevojshme, kryhet një ekspertizë e përshtatshme për të përfunduar përkatësisht për të përgatitur paraqitjen penale në një periudhë prej 10 ditësh, kurse për raste më komplekse edhe deri në dy ose tre muaj.

E RËNDËSISHME! Viktima kundër të njëjtit kryerës dhe për të njëjtin akt mban procedurë penale dhe qytetare për mbrojtje nga dhuna familjare!

ROLI I POLICISË NË PROCEDURË PËR MBROJTJE NGA DHUNA FAMILJARE

Pas rastit të paraqitur për dhunë familjare, policia ka mundësi ligjore:

- ✓ ta thërrasë dhe paralajmëroi dhunuesin se dhuna familjare është e papranueshme dhe e ndëshkueshme;
- ✓ ta arrestojë dhe mbajë dhunuesin në stacion policie nëse ai është agresiv dhe i dhunshëm dhe në përputhje me vlerësimin e rrezikut të përsëritjes së dhunës t'i propozojë gjykatës ta heqë atë nga shtëpia;
- ✓ ta shoqërojë viktimën në shtëpinë e familjes për të marrë rrobat dhe sendet personale që i nevojiten për përditë për të dhe për fëmijët e saj;
- ✓ ta thërrasë kryerësin e dhunës familjare në lidhje me masat e përkohshme të shqiptuara tashmë nga gjykata dhe ta paralajmërojë për dënimin më të rreptë dhe përgjegjësinë penale në rast të shkeljes së tyre;
- ✓ e kontrollon dhe herë pas here kryen vlerësim të zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara nga gjykata;
- ✓ me forcë, kurse në barrë të tij e dërgon të paraqiturin, viktimën dhe dëshmitarin e treguar për dëgjim te Prokurori publik të cilët nuk i janë përgjigjur thirrjes së marrë në mënyrë të rregullt, kurse nuk e kanë justifikuar mungesën e tyre.

E RËNDËSISHME! Çdo vepër penale me elementë të dhunës familjare ndiqet sipas detyrës zyrtare, me përjashtim të veprës penale të lëndimit fizik. Kjo nënkupton se pas raportimit të dhunës familjare dhe dëshmimeve të siguruara për veprën e kryer, viktima nuk ka të drejtë të heqë dorë dhe të kërkojë tërheqjen e paraqitjes, d.m.th. edhe pa një pëlqim të tillë paraqitja penale i dërgohet prokurorit publik.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJ SI VIKTIMË PAS DORËZIMIT TË PARAQITJES

- ✓ të kërkonti nga prokurori publik informacione për çdo fazë të veprimit mbi paraqitjen;
- ✓ të propozoni dëshmi të reja, fakte, dëshmitarë, ekspertizë etj.;
- ✓ të drejtë ankese te Prokuroria e Lartë Publike në rast të hedhjes poshtë të paraqitjes penale;
- ✓ të drejtë pjesëmarrjeje në procedurë në vetinë e të dëmtuarit;
- ✓ të parashtroni kërkesë pronësore juridike për kompensim të dëmit si viktimë e dhunës familjare me kompensim të shpenzimeve shëndetësore si pasojë e lëndimeve nga dhuna familjare.

E RËNDËSISHME! Prokurori publik ka detyrimin të veprjë sipas paraqitjeve penale të ngritura si nga institucionet shtetërore ashtu edhe individët, d.m.th. personalisht nga vetë viktima. Nëse paraqitja penale është e paplotë dhe nuk mund të vlerësohet vërtetësia e pretendimeve në fletëparaqitje, thirrret me patjetër viktima e cila ka të drejtë të propozojë dëshmi shtesë dhe do të ndihmojë për veprime të mëtejshme për fletëparaqitjen e dorëzuar.

MËSIM: Në një situatë kur si viktimë e keni tërhequr miratimin për ndjekje penale kundër dhunuesit (vetëm për veprën penale të lëndimit fizik neni 130 paragrafi 2 i KP-së), për të njëjtën ngjarje kritike ju keni të drejtë të mbrojtjes gjyqësore në procedurat penale, duke i kompensuar të gjitha shpenzimet e bëra në procedurë.

KUJDES! Gjatë procedurës për mbrojtje penale nga dhuna familjare, viktima e dhunës familjare si palë e dëmtuar mund të ndikojë ose kundërshtojë vetëm në pjesën e kërkesës së parashtruar juridike-pasurore, përkatësisht kompensim të dëmit nga kryerësi i dhunës familjare. Kjo do të thotë që viktima nuk ka të drejtë të ankohet për llojin dhe madhësinë e sanksionit penal me të cilin kryerësi i dhunës familjare shpallet fajtor për veprën penale.

ÇFARË TË PRISNI MË PAS

Gjatë procedurave penale apo pas përfundimit të procedurave penale për mbrojtje nga dhuna familjare ka shumë skenarë. Në varësi nga sjellja e dhunuesit mund të ndodhë:

- ✓ dhunuesi të pendohet dhe të shprehë përgatitje të tërësishme ta përmirësojë sjelljen e vet duke i respektuar masat e përkohshme të shqiptuara gjyqësore dhe ta kompensojë dëmin e shkaktuar;
- ✓ dhunuesi të mos i respektojë vendimet gjyqësore dhe ta përsërisë dhunën për të cilën pas paraqitjes në polici me detyrë zyrtare dorëzohet fletëparaqitje penale te prokurori publik për mosrespektim të vendimit gjyqësor.

E RËNDËSISHME: Në rast të përsëritjes apo eskalimit të dhunës familjare është e domosdoshme të merrni vendim për largim nga mjedisi dhunues që si pasojë mund të iniciojë edhe procedura gjyqësore për kontekste familjare siç janë: divorc, dhënie e kujdesit për fëmijët e mitur dhe pagim i detyrimeve, ndarje e pronës së përbashkët e fituar gjatë jetesës së përbashkët, largim nga shtëpia familjare etj.

E RËNDËSISHME! Viktimat e dhunës familjare mund t'u drejtohen njërive rajonale të Ministrisë së Drejtësisë për miratimin e ndihmës juridike pa pagesë, përkatësisht përfaqësimin ligjor pa pagesë dhe çlirim nga të gjitha shpenzimet në procedurat gjyqësore në përputhje me Ligjin për ndihmën juridike pa pagesë. Gjithashtu, për ndihmë juridike dhe përfaqësim ligjor pa pagesë, viktimat mund t'u drejtohen OQ-ve që ofrojnë shërbime juridike falas edhe për këtë kategori më të lëndueshme të personave.